

VENDIM
Nr. 554, datë 11.9.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 689, DATË 26.10.2022, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT ME EMËRTIM
‘ISH-SANATORIUMI’, BASHKIA KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 689, datë 26.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të objektit me emërtim ‘Ish-Sanatoriumi’, Bashkia Korçë”, togfjalëshi “... me sipërfaqe të përgjithshme të truallit 6 888 m² (gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) ...” zëvendësohet me “... me sipërfaqe të përgjithshme të truallit 7 036 m² (shtatë mijë e tridhjetë e gjashtë) ...”.

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku